

Menaxhojeni kujdesin tuaj shëndetësor prej kudo

Me NYC Health + Hospitals MyChart, mund ta menaxhoni kujdesin tuaj shëndetësor nga celulari apo kompjuteri. Pasi të regjistroheni dhe të identifikoheni në MyChart, mund të:

- + Shikoni testin tuaj dhe analiza të tjera laboratorike
- + Dërgoni mesazhe të sigurta te mjeku
- + Kërkoni furnizim me mjekime
- + Planifikoni takime dhe të regjistroheni përpara vizitës
- + Shkarkoni e ndani dosjen tuaj mjekësore, etj.

Për të mësuar më shumë rreth MyChart vizitoni mychart.nychealthandhospitals.org ose pyesni ekipin tuaj të kujdesit.

Pagesa për kujdesin tuaj shëndetësor

Ju keni të drejtën të merrni kujdes shëndetësor të cilësisë së lartë dhe ekonomikisht të përballueshëm, pavarësisht aftësisë suaj për të paguar apo statusit tuaj të imigrimit. Telefononi në nr. 1-646-694-3131 për të mësuar rreth opsioneve që ju ofrohen juve dhe familjes suaj.

MetroPlusHealth

Plani i sigurimit shëndetësor i vetë NYC Health + Hospitals ofron sigurim shëndetësor me kosto të ulët ose pa kosto fare për të rriturit, fëmijët dhe familjet, si dhe ofron plane speciale për punonjësit e administratës së qytetit, personat me HIV dhe ata që kanë nevojë për kujdes afatgjatë. Telefononi në nr. 1-800-475-METRO ose 1-800-475-6387 për të mësuar më shumë.



NYC Care është një program i aksesit në kujdesin shëndetësor që garanton shërbime me kosto të ulët ose pa kosto fare për njujorkezët që nuk kualifikohen për sigurimin shëndetësor apo që nuk mund ta përballojnë sigurimin shëndetësor. Telefononi në nr. 1-646-NYC-CARE ose 1-646-692-2273.

PËR TAKIM, TELEFONONI NË NR.

1-844-NYC-4NYC

(1-844-692-4692)

Jeto jetën tënde më të
shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



RUANI LIDHJET. NA NDIQNI.

www.nychealthandhospitals.org

Albanian 08/20



NE JEMI
KËTU ➔ +
PËR JU.

Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Përkujdesja për shëndetin tuaj është e rëndësishme. NYC Health + Hospitals jua bën të lehtë e të sigurt marrjen e kujdesit që keni nevojë.

Si kur është koha për të planifikuar kontrollin vjetor apo për të riplanifikuar një vizitë të kujdesit parandalues apo procedurë që e keni lënë pas dore, mjekët tanë janë gati për t'ju vizituar.

Ne po bëjmë gjithçka është e mundur për t'ju mbajtur të sigurt kur mbërrini në një prej qendrave tona. Personeli ynë mban gjithnjë maska dhe pajime mbrojtëse. Gjithkush që hyn në spitalet, sallat e urgjencës apo klinikat tona depistohet për simptoma të COVID-19. Të gjithë pacientët dhe vizitorët duhet të mbajnë maskë dhe të praktikojnë distancimin fizik. Të gjitha qendrat tona pastrohen e dezinfektohen gjatë gjithë ditës.





Si të takoheni me mjekun

Takimi me mjekun apo infermieren është i lehtë dhe i sigurt. Takimin mund ta lini që sot për vizitë në person, telefon apo video nga komoditeti i shtëpisë suaj. Telefononi në nr. **1-844-NYC-4NYC** (1-844-692-4692). Pyesni ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor se cili opsion është i duhuri për ju.



Takimet në person

Klinikat tona janë të sigurta dhe të hapura për të ofruar kujdes shëndetësor. Ne pranojmë pacientë të rinj dhe planifikimin e takimeve në person. Telefononi për të pyetur për oraret e posaçme për ju nëse jeni i moshuar apo më i rrezikuar nga COVID-19.



Vizita kontrolli të shpejtë

Ky është një opsion i ri e i shpejtë kur ju duhen analiza laboratorit apo kontrolli treguesve jetikë si p.sh. tensioni, rrahjet e zemrës dhe pesha. Pyesni ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor nëse ky është opsioni i duhur për ju.



Vizitat me telefon dhe video

Mund të flisni me mjekun apo infermieren tuaj nga shtëpia përmes një televizite me telefon apo video. Operatori juaj do t'ju telefonojë në orarin e planifikuar të takimit tuaj. Për vizitat me video, mund të lidheni kur të identifikoheni në portalin e pacientëve MyChart.

Ne jemi këtu për ju. Një vend për të gjitha nevojat tuaja të kujdesit shëndetësor.

- + KUJDES PARËSOR PEDIATRIK DHE PËR TË RRRITUR
- + KARDIOLOGJI
- + DERMATOLOGJI
- + KUJDES URGJENT
- + GASTROENTEROLOGJI
- + SHËRBIME TË SHËNDETIT MENDOR
- + NEUROLOGJI
- + PULMONARE
- + KUJDES URGJENT VIRTUAL
- + SHËNDETI I GRAVE

Askujt nuk duhet t'i mungojë kujdesi i nevojshëm shëndetësor. NYC Health + Hospitals ka ngritur protokolle të detajuara sigurie për t'i pasur të gjithë pacientët të sigurt gjatë marrjes së kujdesit shëndetësor. Është veçanërisht e rëndësishme që fëmija të mos i humbasë vizitat e kontrollit për fëmijë apo vaksinat.

Nëse keni hasur simptoma iktusi apo ataku kardiak, keni dhimbje të forta apo çfarëdo urgjence tjetër, mos e shtyni trajtimin nga frika e ekspozimit ndaj COVID-19. Të gjitha sallat e urgjencës të NYC Health + Hospitals kanë zona të posaçme për pacientët me simptomat e COVID-19. Telefoni 911 ose paraqituni në shërbimin më të afërt të urgjencës për të marrë kujdesin shëndetësor.

Teste falas për COVID-19 dhe të antitropave

Kryejeni sot testin për të mbrojtur veten dhe njerëzit tuaj të dashur. Të gjithë njujorkezët duhet të testohen për COVID-19, edhe nëse nuk kanë simptoma. Testet janë falas, të sigurt, të shpejta dhe të lehta. Telefoni 1-877-CVD-19NY (1-877-283-1969) për të gjetur një pikë testimi pranë jush.

